

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Mitrovicë z. Avni Kastrati**

I nderuari z. Kastrati,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju kemi premtuar:

- Asfaltimin/rregullimin e rrugëve: Bajgorë-Kovaqicë; Vidishic- Selac; Mazhiq-Rashan-Pasomë, Kaqandoll – Rëzhanë, Melenicë – Zabërgjë si dhe asfaltimin e rrugëve të fshatrave të Komunës së Leposaviqit: Kushtovë, Bistricë, etj;
- Ndërtimin dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bajgorë, Bare, Trepçali, Stantërg.
- Lirimin e banesave të shqiptarëve që janë të uzurpuara në veri të Mitrovicës;
- Angazhim në krijimin e infrastrukturës sportive dhe zhvillimin dhe avancimin e sportit;
- Krijimin e kushteve më të mira për jetë, duke rregulluar infrastrukturën rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimet;
- Lëvizje më të lirë dhe siguri për të gjithë;
- Vazhdimin e punimeve në ndërtimin e shtëpive në veri;
- Angazhim në krijimin e një sistemi funksional shëndetësor në Komunën e Mitrovicës;
- Zgjidhjen e problemit të orarit të punës në çerdhen e vetme të fëmijëve "Gëzimi Ynë", e cila momentalisht punon deri në ora 4, duke bërë që shumë qytetarë që punojnë deri në orën 5 të detyrohen të bëjnë zgjidhe alternative pas kësaj kohe; dhe ndërtimin e një çerdheje të re;
- Krijimin e një zone të lire ekonomike në Mitrovicë, e cila do të mundësojë gjenerim vendesh të reja pune dhe ku aktivitetet e zhvilluara në këtë zonë do të kenë tatim zero;
- Realizimin e modelit më të mirë në vend për zgjidhjen e problemeve të pjesëtarëve të kategorive të dala nga lufta;
- Realizimin e të gjitha projekteve të parashtruara nga qytetarët;
- Përmirësimin e objekteve të sportit; sigurimin e hapësirave punuese për klubet e shoqatave sportive; sigurimin e mjeteve për pjesëmarrjen e sportistëve të rinj në aktivitetet sportive;
- Ndërtimin e një universiteti evropian në Mitrovicë; mbështetje për fakultetet në Mitrovicë dhe hapjen e drejttimeve të tjera, si psh. Fakultetin e Edukimit, Mjekësisë, etj.
- Në 2010 investime dy herë më të mëdha sesa gjatë dy viteve të kaluara;
- Mbështetje për shoqatën e familjeve të të pagjeturve "Kujtimi";
- Për fshatin Vinarc: asfaltimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave, zonën rekreative shumë të bukur me një liqe dhe shëtitore në të dy anët e lumit, e cila do t'i japë epitimin e një fshati turistik dhe do të sjellë përfitime për banorët e këtij fshati;
- Investime në infrastrukturë, shkolla, rrugë dhe krijimin e vendeve të punës;
- Kushte më të mira për pensionistët;
- Mbështetjen e politikave që mundësojnë zhvillim ekonomik;
- Sistem arsimorë e shëndetësorë bashkëkohorë;

- Mirëqenie sociale;
- 120 milionë euro investime për katër vitet në vazhdim, premtim ky i Kryeministrit Thaçi;
- Më shumë investime për lagjen "Ilirida";
- Zgjedhjen e problemit për ujin e pijshëm (Projekt në bashkëpunim me Komisionin Evropian në vlerë prej 10 milion euro gjatë mandatit 4 vjeçar);
- Rregullimin e Sheshit Qendror me vlerë prej 700,000 Euro;
- Ndërtimin e impiantit për përpunimin e ujërave të zeza;
- Një projekt i veçantë ku çdo familje do të ketë trungun familjar, 25,000-26,000 familje, që do të thotë 25,000 – 26,000 drunj - e ky premtim për të siguruar gjelbërimin e qytetit, dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve.

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)